



REPUBLIKA E KOSOVËS
KUVENDI I KOMUNËS - SHTIME
Komiteti për Politikë dhe financa
Nr.01-060/01-32077/24 datë:17.12.2024



Npi – 01/432 datë: 23.12.2024

Duke u bazuar në nenin 49 dhe 52 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040, ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës" Nr. 28/2008); Si dhe në bazë të nenit 4.13 të Rregullores të Punës së Kuvendit dhe Komiteteve Npi – 01/155 datë: 27.04.2023, Komiteti për Politikë dhe Financa në mbledhjen e mbajtur më: 23.12.2024 nxjerr këtë:

E K S T R A K T
P R O C E S V E R B A L

I MBLEDHJES SË -XII- TË KOMITETIT PËR POLITIKË DHE FINANCA
E mbajtur më datën: 23.12.2024 (e hënë) në ora 14:00 h. në sallën e vogël të Kuvendit

Në mbledhje kanë marrë pjesë: Kryesuesi i KPF-së z.Adnan Ademi, Anëtarët e Komitetit: z.Përparim Ramusa, z.Lumni Amrush, znj.Adelina Beqaj, znj.Saniye Sadiki, znj.Zejnije Veliu dhe z.Kadri Emini. Përveç anëtarëve të KPF-së në mbledhje ka marrë pjesë edhe: Zyrtarja për Informim znj.Vlora Hyseni, dhe Albion Shabani.

Mbledhjen e hapi, Kryesuesi i KPF-së z.Adnan Ademi, i cili pasi përshëndeti të gjithë të pranishmit, konstatoi Kuorumin e mjaftueshëm për mbajtjen e mbledhjes. Për këtë mbledhje kemi propozuar këtë:

REND DITE

1. Shqyrtimi i Ekstrakt Procesverbalit nga mbledhja e mbajtur më: 27.11.2024,
2. Propozim-Vendim për anulimin e Vendimit Npi-01-156 dhe Planin për Integritet Npi-01-157 të datës 27.04.2023,
3. Propozim-Vendim për plotësim-ndryshimin e vendimit Npi- 01-291 dt. 27.09.2022 për KKSB,
4. Raporti i përgjithshëm i 6-mujorit të II-të i Punës së ekzekutivit në Komunën e Shitmes,
5. Orari i mbledhjeve të KPF-së për vitin 2025,

Kryesuesi, z.Adnan Ademi: Hapi diskutimin për rendin e ditës.

*** Komiteti për Politikë dhe Financa, unanimisht miratoi rendin e ditës.**

Pika 1

Shqyrtimi i Ekstrakt Procesverbalit nga mbledhja e mbajtur më: 27.11.2024

Kryesuesi, z.Adnan Ademi: Hapi diskutimin për këtë pikë.

*** Komiteti për Politikë dhe Financa, unanimisht miratoi Ekstrakt-Procesverbalin nga mbledhja e mbajtur më 27.11.2024.**

Pika 2

Propozim-Vendim për anulimin e Vendimit Npi-01-156 dhe Planin për Integritet Npi-01-157 të datës 27.04.2023

Kryesuesi, z.Adnan Ademi: Hapi diskutimin për këtë pikë.

z.Përparim Ramusa: Përshëndetje. Kërkoj një scharim për këtë pikë, sepse nuk kemi material.

Kryesuesi, z.Adnan Ademi: Siç e dini ne në këtë Kuvend ne e kemi miratuar Vendimin për miratimin e Planit për Integritet Npi-01-157 të datës 27.04.2023. Tani duke u bazuar në Ligjin e ri,

Nr.08/L-017, për Agjensinë për Parandalimin e Korrupsionit, në Komunitet e Kosovës, Drejtoria për Administratë të përgjithshme i ka propozuar Kuvendit, miratimin e vendimit për anulimin e Vendimit Npi-01-156 dhe Planin për Integritet Npi-01-157 të datës 27.04.2023, me arsyetimin se Plani i ri për Integritet do të harmonizohet me obligimet strategjike të përcaktuara me Ligjin e ri Nr.08/L-017, dhe këtë plan do ta hartojë grupi punues dhe do të miratohet vetëm nga Kryetari i Komunitetit, dhe nuk ka nevojë me ardhur në Kuvend.

Kryesuesi, z.Adnan Ademi: Konstatohet Kuorumi prej 7 anëtarëve të KPF-së prezent në mbledhje.

*** Komiteti për Politikë dhe Financa, unanimitas vendosi t'i Rekomandon Kuvendit, miratimin e Vendimit për anulimin e Vendimit Npi-01-156 dhe Planin për Integritet Npi-01-157 të datës 27.04.2023, me propozimin që drejtori të vjen në seancë të Kuvendit dhe ta sqarojë në detaje.**

Pika 3

Propozimi-Vendim për plotësim-ndryshimin e vendimit Npi- 01-291 dt. 27.09.2022 për KKSB

Kryesuesi, z.Adnan Ademi: Gjatë kësaj periudhe prej kur është formuar KKSB-ja i kemi disa ndryshime të anëtarëve, të KKSB-së qoftë për arsye të ndrrimit të pozitave të tyre qoftë për shkak të mungesave të pa arsyeshme të tyre, prandaj nevojitet të bëhet një ndryshim i këtij vendimi. Ne nga këtu po kërkojmë që në mbledhjen e Kuvendit nesër të na sqarohen arsyet dhe emrat që duhet të ndryshohen. Hapi diskutimin.

Kryesuesi, z.Adnan Ademi: Konstatohet Kuorumi prej 7 anëtarëve të KPF-së prezent në mbledhje.

***Komiteti për Politikë dhe Financa, unanimitas vendosi t'i Rekomandon Kuvendit, miratimin e Vendimit për plotësim-ndryshimin e vendimit Npi- 01-291 dt. 27.09.2022 për KKSB, me propozimin që dikush nga Ekzekutivi të vjen në seancën e Kuvendit dhe ti prezantojë ndryshimet në këtë vendim.**

Pika 4

Raporti i përgjithshëm i 6-mujorit të II-të i Punës së ekzekutivit në Komunitetin e Shtimit

Kryesuesi, z.Adnan Ademi: Hapi diskutimin për këtë pikë.

z.Perparim Ramusa: Çka mund të diskutojmë, kur materialin e kemi marrë dy orë para mbledhjes, kështu që kërkesa jonë është që kjo pikë të shkojë direkt në Kuvend.

Kryesuesi, z.Adnan Ademi: Konstatohet Kuorumi prej 7 anëtarëve të KPF-së prezent në mbledhje.

***Komiteti për Politikë dhe Financa, unanimitas vendosi që, Raporti i përgjithshëm i 6-mujorit të II- të Punës së ekzekutivit në Komunitetin e Shtimit, të shkojë direkt në Kuvend, meqenëse materiali na ka ardhur me vonë.**

Pika 5

Orari i mbledhjeve të KPF-së për vitin 2025

Kryesuesi, z.Adnan Ademi: Hapi diskutimin për këtë pikë.

znj.Adelina Beqaj: Ne si Komision jemi takuar, kemi punuar dhe e kemi bërë një punë të mirë. Propozimin e kemi marrë me kohë dhe e kemi lexuar. Orarin e mbledhjeve e kemi harmonizuar me orarin e mbledhjeve të Kuvendit, por e kemi bërë një ndryshim, nga orari i mbledhjeve të vitit të kaluar nga ora 9 sa ka qenë e kemi propozuar të jetë në ora 10:00h.

Kryesuesi, z.Adnan Ademi: Konstatohet Kuorumi prej 7 anëtarëve të KPF-së, prezent në mbledhje.

*** Komiteti për Politikë dhe Financa, unanimitas miratoi vendimin për caktimin e Orarit të mbledhjeve të Komitetit për Politikë dhe Financa për vitin 2025.**

Kryesuesi, z.Adnan Ademi; Meqenëse diskutime tjera nuk ka, Kryesuesi mbledhjen e përfundoi në ora 14:25h.

Procesmbajtësi
Idajet Rexhepi



Kryesuesi i KPF
Adnan Ademi

